

VENDIM
Nr.113, datë 17.2.2007

**PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, PËRBËRJEN DHE PËRCAKTIMIN E MASËS
SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMITETIT NDËRSEKTORIAL, PËR
MBROJTJEN NGA PRODUKTET E DUHANIT (KNMSHPD)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD), me kryetar Ministrin e Shëndetësisë, dhe me këtë përbërje:

- | | |
|--|---------|
| - Zëvendësministri i Financave | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Brendshëm | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë
dhe Sporteve | anëtar; |
| - Kryetari i Këshillit Kombëtar i Radios
dhe Televizionit Publik Shqiptar | anëtar; |
| - Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik | anëtar; |
| - Kryeinspektori Sanitar Shtetëror | anëtar; |
| - Drejtori i Policisë Bashkiake, Tiranë | anëtar; |

Funksionet e sekretarit të KNMSHPD-së kryhen nga Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik.

2. KNMSHPD-ja përgjigjet për detyrat e ngarkuara në nenet 4 dhe 18 të ligjit nr.9363, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

3. KNMSHPD-ja mbledhet jo më pak se 4 herë në vit dhe thirret nga kryetari, i cili, 5 ditë para mbledhjes, u njofton anëtarëve rendin e ditës dhe u dërgon atyre materialet përkatëse.

4. Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve dhe vendimet merren me shumicë votash. Në rast barazimi të votave “pro” dhe “kundër”, vota e kryetarit është përcaktuese.

5. Anëtarët e KNMSHPD-së, caktojnë, në çdo mbledhje, me shumicë votash, rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme.

6. Shpërblimi për pjesëmarrësit, për çdo mbledhje, është 5 000 (pesëmijë) lekë.

7. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

8. Krahas detyrave të përcaktuara në ligjin në fuqi, KNMSHPD-ja përcakton formën dhe tekstin e mesazheve në çdo njësi pakete apo paketimi të produkteve të duhanit. Përditësimi i tyre bëhet, minimalisht, çdo 2 vjet.

9. Sekretari i KNMSHPD-së mban procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari.

10. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha